



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA

Pratuar - Pribiluar - Miratuar			
10.12.2015			
Nr. i Organeve Org. b. b. j.	Num.	Titulli	Vlera
01-013/1644			



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Bazuar në nenin 12.2 shkronja d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kuvendit të Republikës së Kosovës Gazeta zyrtare nr 2008/28 dhe nenit 36 pika d) të Statutit të Komunës së Vitisë nr 01-013/491 të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në seancën e mbajtur më 08.12.2015 aprovon këtë:

V E N D I M

PËR SHPALLJEN E DISKUTIMIT PUBLIK PËR PROPOZIM RREGULLOREN PËR VENDOSJEN, NDËRTIMIN DHE LARGIMIN E OBJEKTEVE TË PËRKOHSHME NË PRONËN PUBLIKE

I.

Kuvendi i Komunës së Vitisë SHPALL diskutim publik për propozim Rregulloren për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike për Komunën së Vitisë.

II.

Propozim Rregullorja për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike për Komunën së Vitisë do të jepet në diskutim publik deri më 16.12.2015.

III.

Debati me publikun do të mbahet më 16.12.2015 në ora 10,⁰⁰ në sallën e Kuvendit të Komunës së Vitisë,

IV.

Të drejtë pjesëmarrje në diskutim publik kanë të gjithë qytetarët e interesuar, organet dhe institucionet e Komunës së Vitisë.

V.

Qëllimi i këtij diskutimi publik është për të krijuar opinione pozitive për propozimet e bëra për Propozim Rregulloren për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike për Komunën së Vitisë, para se të miratohet në Kuvend.

VI.

Materiali lidhur me Propozim Rregulloren për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike për Komunën së Vitisë mund të merret në Shërbimin e Kuvendit, Zyrën Ligjore dhe i njëjti do të jetë i shpallur në tabelën e shpalljeve dhe në Veb faqen e Komunës së Vitisë në internet.

VII.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

KRYESUESI I KUVENDIT

Naim Pira

